

EMIL LAJE

TRAJTAT E URDHËRORES TE GJON BUZUKU

Mënyra urdhërore në Mesharin e Gjon Buzukut përdoret shpesh dhe kjo na jep në dorë një material të mjaftë për të parë ndërtimin e trajtave të ndryshme të saj të njëjësit e të shumësit, të dialektit veprorë e pësorë për të katër zgjedhimet e klasat e tyre¹).

Diateza veprorë. Veta e II-të njëjës.

Foljet e zgjedhimit të I-rë e të II-të, që përbëjnë shumicën e foljeve konsonantike të shqipës, që te Buzuku e kanë humbur në masë «mbaresën e vjetër -ë», siç e quajnë Gj. Pekmezi (Grammatik der alb. Sprache, ff. 171-174) e M. Domi (M. H. f. 56). Kështu prej këtyre zgjedhimeve janë pa mbaresë shëmbullat që pasojnë:²) zgj. I, kl. I: *dëllir* (4), *dëllir* (2), *grish* (4), *gjegj* (16), *mos mbërshil*, *uçil* (5), *ndër* (2), *ndëreq* (2), *njal* (10), *nlihdh*, *puth*, *mos më qell n dhunë* (2) (në illudas me), *vëliz*, *zgjidh* (2); kl. II: *mos bdir*, *del* (4), *hiq* (19), *mer* (23), *ndiq*, *nhiq*, *njih*, *zgiedh* (177), *vidh* (3); zgj. II kl. I: *grabit*, *it* (nga «jes») (3), *këput* (2), *kullot* (2), *lut* (3), *padit* (2), *prit*, *pyet*, *qit* (3), *ritt*, *shit*, *zbrit* (5); kl. II: *thir*, *thirr* (2); nga foljet supletive: *ep* (100), *shih* (8). Le të përmendim këtu edhe *eja* (18).

Te foljet *mbërshil*, *uçil*, *njih*, *vidh* fonemat -e-, -je- të temave *mbërshel* *uçel*, *njuh*, *vjedh* janë ndruar në -i-, siç duket nën ndikimin e shumësive *mbërshilni*, *uçilni*, *vidhni*, por te foljet *del*, *mer* e *zgiedh* ky ndrim nuk është zbatuar.

Me mbaresën -ë gjejmë këto shëmbëlla: zgj. I, kl. I: *ecë* (56), *hipë* (2), *këqyrë* (24), *lypë*, *mos më prekë*, *stripë* (2); kl. II: *ndjekëmë*, *nxjerë*, *nxjerëmë*, *rjedhë*, *sjellë*; zgj. II, kl. II: *folë* (5); zgj. III, kl. I: *hinë* (5); por edhe *hī* (2), *nginjë*, por edhe *nginnj*; zgj. IV kl. II *bjerë* (rënë), *bjerë* (prurë) (3), *bjerëmë* (3), *shpjerë*, *shpjerëna*, *shtjerë* (10), *venë* (4), *përvenë* (5).

Te *bjerë*, *shpjerë*, *shtjerë*, *venë*, *përvenë* ruajtja e tingujve fuondorë -r-, -n të temës në urdhëroren e në vetën III-të njëjës të lidhore dhe rënia e tyre në dëftoren (unë, ti, ai, bie, shpie, vë etj.) spiegotet pikërisht me ruajtjen e mbaresave vetore te ato mënyra dhe me rënien e tyre në njëjësën e së tashmes së dëftores. Kjo na shtyn

1) Në këtë kumtesë kemi zbatuar ndarjen tradicionale në katër zgjedhime ashtu siç paraqitet në dispensën «Morfologjia Historike» (më tej M. H.) të M. Domit, Tiranë 1961, ff. 33-44.

2) Shëmbëllat jepen sipas transkribimit të Prof. E. Çabejt. Për trajtat që janë përdorur më shumë se një herë shënohet në kllapa numri i përdorimeve. Për mungesë vëndi referencat jepen në disa raste të rralla, sidomos kur trajta e foljes është marrë me gjithë kontekst; në to numri i parë tregon faqen sipas numërtimit të plotë të tekstit të Buzukut në gjëndjen e sotme, gërma a kolonën e majtë, gërma b kolonën e djathtë dhe numri i dytë radhën.

të mendojmë se mbaresa -ë e urdhërores është relativisht e vjetër, dhe si e tillë, në pajtim me fonetikën historike të shqipes, përfaqëson ndoshta rezultatit e reduktimit të një zanoreje të gjatë të patheksuar, por nuk përjashtohet edhe mundësia që të jetë një shtesë gjatë zhvillimit të brendshëm të shqipes.

Po pse kjo mbaresë -ë ka rënë kaq shumë që te Buzuku, i cili në të gjitha rastet e tjera e ka rregullisht -ë-në fundore? Dihet se arësyeja e rënies së zanores -ë fundore në gjuhën shqipe është karakteri dinamik i theksit. Te urdhërorja ky karakter dinamik çfaqet me një intensitet shumë më të fortë, duke shkaktuar rënien e mbaresës -ë më parë se në fjalët e trajtat fonetike analoge, p.sh. *ditë* (emër) — *padit* (folje në urdhërore) etj. Këtë pamje që na del te Gjon Buzuku e shohim edhe sot te toskërishtja, ku edhe në ato të folme që e ruajnë -ë-në fundore, mbaresa -ë e urdhërores ka rënë në shumicën e rasteve.

Foljet me temë origjinare vokalike në të tashmen (zgj. III-të kl. II-të, zgj. IV-të kl. I-rë) e formojnë vetën e dytë njëjës të urdhërores nga kjo temë e pa ndonjë mbaresë. Nderkaq do thënë se te Gjon Buzuku numri i foljeve që nuk e kanë zgjeruar temën e së tashmes me një -n, është më i madh se në gegërishten e sotme letrare¹). Nga këto folje në urdhërore janë përdorur: *m̃ba* (2), *përd̃a*, *le* (3), *ngre* (8), *ha* (4), *ri* (4). Me këto trajta del edhe njëjësi i së tashmës së dëftores për të tria vetat. Këtu duhet të shtojmë edhe *ñvra* (6), e vetmja trajtë e urdhërores së foljes *vras*, tek e cila ndërkaq shumësi është *ñvritëni*.

Urdhëroret e foljeve të tjera, të cilat që te Gjon Buzuku e kanë zgjeruar temën e së tashmes me një -n, po i grupojmë kështu:

a) folje më -o: *absolvo*, *adoro*, *bdo* (2), *beko* (2), *beso*, *defendo* (14), *despenso*, *dëfto* (4) *dërgo* (7), *dëshëro* (3), *dëshmo* (2), *fabriko*, *forco* (2) *gëzo* (2), *gjuko*, *kallëzo*, *kastigo* (2), *konfirmo*, *konforto*, *konservo*, *kujo*, *largo*, *lësho* (5), *lëvdo* (5), *libero* (3), *liro* (6), *mos mallëko*, *majshtro*, *m̃baro*, *mos qell ñ dhunë faqenë e d vobegut*, e *mos m̃barro* faqenë e d begatët me i bām ndër. (Non consideres personam pauperis, nec honores vultum potentis), *m̃jeko*, *m̃pso*, *mundo* (2), *ñço*, *ndëro*, *ndiglo* (31), *ndimo* (4) *ndishko* (2), *ñqo*, *ordëno* (2), *ordhëno* (4), *oro*, *parifiko*, *pusho*, *rutullo*, *santifiko*, *soliçito* (2), *shelbo* (5), *shenjtëno*, *shenjto*, *shkatëro*, *shpëto* (3), *shto*, *shtrëngo* (2), *shumo* (2), *tempero*, *tento*, *mos turpëno*, *vepëro*, *vono* (3);

b) folje më -e: *deshpëlqe* (3), *kt̃he* (11) (*ñkt̃he*, *ndije* (8), *ngre* (9), *ñthe*, *shkënxe*, *ushqe*;

c) folje më -i: *përtëri* (4);

ç) folje më -uo: *mos druo*.

Të tjera folje me urdhërore vokalike janë: a) zgj. III-të kl. I-rë *hi* (2), por edhe *hinë* (5); b) zgj. IV-të kl. II *përze* (30), *xe*, folje origjinarisht konsonantike, por që e kanë humbur bashkëtingëlloren fundore -n të temës së të tashmes (khs. aor. *përzuna*); c) foljet atematike: *ī* (17), *kī* (70) (të dyja me *ī* të gjatë), *thuo* (20) e *uite* (22). Siç do të shohim më poshtë krahas *thuo* përdoret edhe *thuoj* (2). Trajta *uite* është urdhërorja e foljes «vete», e bërë bisilabike me një -te, ashtu si vetë

1) S. Riza, «Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe». Krestomati thjesh-të gjuhësore, Tiranë 1961, f. XXII.

folja «vete» (khs. sot *kamte, jamte, bëjte, vite* të Vlorës me rrethe). Sot kjo trajtë ka humbur dhe folja «vete» ka mbetur pa urdhërore të sajën. Ashtu si çamërishtja dhe Buzuku ka *amë* 5) (urdhërorja e foljes jap plus trajtën e shkurtër *-më* të përemrit vetor).

Një numër foljesh me temë më *-a, -e, -i, -y, -uo, -ye*, në vetën e dytë njëjës marrin një *-j* fundore e cila është spieguar si tingull antihiatizues, i lindur gjatë përdorimit të urdhërores me trajtat e shkurtëra vokalike të përemrit vetor: *da + e > da -j-e*, dhe *pastaj* i shtrirë edhe në rastet e përdorimit pa përemrin enklitik (M. Domi, M. H. f. 56). Te Gjon Buzuku gjejmë këto folje me një *-j* të tillë fundore: *daj* (4), *klaaj, laj* (3), *përdaj, shaj* (2), *vgjaj* (24), *vgjāj* (2), *ndej* (9), *bdi, fryj, pështyj, druo, duoje, ruoj* (11); *shkruoj* (5), *thuo* (2), *lyej*. Siç e kemi parë, Buzuku përdor edhe trajta pa *-j*, p.sh. *mos druo, mba* (2), *përdā, thuo* (20).

Për foljet që në urdhërore dalin më *-o*, Gjon Buzuku nuk e ka ndërë nevojën të shtojë një *-j* antihiatizuese dhe shkruan kurdoherë *gjukoe, mbëloe, ndishkoe, qërtoe* e jo *gjukeje, mbëloje, qërtoje*, siç do ta praktikonte sot gjuha e shkrimit. Duket se në dialektin e tij togu zanor *oe* shqiptohet atëhere pa ndonjë vështirësi që të kërkonte lindjen e një tingulli antihiatizues. Kjo nuk duhet parë shkëputur nga fati i togut *oe* në fjalë të tjera si *voe, voesa* etj. që i gjejmë kështu te ky autor¹⁾.

Më së fundi po shënojmë se për urdhëroren e foljes «bëj» te Gjon Buzuku gjejmë vetëm trajtën *ban* (92), *bān* (2), *bani, banmë, bana* (2).

Veta e II-të shumë.

Veta e II-të shumë për të katër zgjedhimet formohet me anë të mbaresës *-ni*, njësoj si sot, dhe është kështu homonimike me vetën e II-të shumë të dëftores, p.sh.: zgj. I-rë: *këqyrni, lypëni, mbathni, mbushni, ndreqni* etj.; *delni, mbëlidhni, nçilni, ridhni, sillni, vidhni* etj.; zgj. II-të: *itëni, lutëni; flitëni, nvrinë; shtinë* etj.; zgj. III *bani; dani, klani, mbani, adroni, besoni, fabrikoni, levdoni, pushoni sakrifikoni* etj., zgj. IV *përvini, përzini, vini, xini, zini* etj.; nga foljet supletive: *eni* (20), *epëni* (3), *epëni* (2), *epni*.

1) Edhe sot, megjithëse gjuha e shkrimit e shqiptimi letrar përdorin *punoje, tregoje* etj., trajtat pa përemrin enklitik janë *puno, trego*, etj pa *-j* fundore. Spiegimi se kjo *-j* fundore nuk u shtri edhe te foljet me urdhërore më *-o* si *puno* «për ta diferencuar vetën e dytë të urdhërores nga veta e tretë e aoristit (aoristi *punoj*, shqiptuar *punoj*, kurse *laj* s'ka mundësi përzjerjeje se aoristi bën *lau*)» (M. Domi, M. H. f. 57) na duket i kërkuar, po të kemi parasysh edhe numrin e madh të aoristeve me mbaresën *-u* që përdor Buzuku për foljet me temë më *-o*, si: *beko, beso, bë, dërgo, forco, lësho, ordhëno* etj. për *lëvdo, provo, rutullo, shko, shkro* etj. Veç kësaj në përdorimin praktik aoristi nuk mund të ngatërohet me urdhëroren, ashtu siç nuk ngatërohet as me vetën e I-rë njëjës të dëftores. Ne besojmë se spiegimi duhet kërkuar në vjetërsinë e daljes së *-j*-së antihiatizuese në tipet e ndryshme të foljeve vokalike: atje ku doli më heret, d.m.th. te foljet me *-a, -y, -uo, -ye* e për analogji me to edhe te foljet me *-e, -i* (siç e dëshmon Buzuku), arriti të përhapet edhe në trajtat pa përemrin enklitik, atje ku doli më vonë, d.m.th. te foljet me *-o* (edhe sot ka dialekte që thonë *dërgoe, marloe*) nuk arriti të përhapet në trajtat pa përemrin enklitik.

Ashtu si vetën e II-të shumë të dëftores, edhe këtu te foljet me *-e-s-je-* në temë ka ndodhur ndrimi *-e-, -je-* > *i*, p.sh. *mbëlidhni* (3), *mbërshilni*, *ncilni*, *nvishni*, *ridhni*, *sillni*, *vidhni*; *itëni* (15); *rwritëni* *qitënie* (2), *shitni*, *flitëni*, *grëshitnie*, *thërritëni*; *blini* (2), *lini* (2), *lini*, *përvini*, *përzini* (4), *xini* (3), *zini*; *shihni* (3). Ky ndrim nuk është vërtetuar te foljet *delni*, *deli*; *meri*, *merri*.

Disa folje e formojnë urdhëroren me mbaresën *-i* ose dhe me *-i* dhe me *-ni*. Mbaresa *-i*, të paktën përse i përket dëftores, mbahet si më e vjetër se *-ni* (shih M. Domi, M. H. f. 47 v.) Këto folje janë: *bdiri*, *biri* (3), *birimë* (2), *deli* (2) (por edhe *delni*), *mos nfali*, *meri* (6), *merie* (2), *merije*, *merri*, *përhëndeti*, *sillie*, *shpiri*; *shtiri*.

Siç mund të vrehet lehtë, mbaresa *-i* është ruajtur kryesisht pas një teme më likuide *r*, *rr*, *l*, *ll*.

Trajtat *bdiri*, *biri*, *shpiri*, *shtiri* te të cilat në vështrim të parë duket sikur kemi një rotacizëm *bdini* > *bdiri* etj., janë formuar nga tema origjinare me *-r* e këtyre foljeve me anë të mbaresës *-i*, e cila ka shkaktuar edhe ndrimin e grupit *-je-* në *-i*.

Siç na kumtojnë Prof. E. Çabej, M. Totoni e A. Dhrimo, të tilla trajtat janë të zakonshme sot në labërishten, dhe kjo është një nga ato pika ku ky dialekt piqet në mënyrë të çuditëshme me gjuhën e Gjon Buzukut, kur dialektet e tjera të shqipës, duke mos përjashtuar as gegërishten veriore, janë larguar mjaft nga gjuha e autorit tonë më të vjetër.

Edhe foljet «kam» e «jam» e formojnë shumësin gjithashtu me anë të mbaresës *-ni*, por në dallim nga njëjësi zanorja e temës tani nuk është e gjatë: *kini*, *ini*. Kjo bie në kundërshtim me pohimin e Boppit se «të dyja foljet-ndihmëse kanë në vetën e dytë shumë të urdhërores një *i* të gjatë»¹).

Këtë parashtrim të trajtave të njëjësit e të shumësit të urdhërores (diateza vepore) po e përmbyllin me një vrejttje formimit të tyre. Për mendimin tonë veta e II-të njëjës e urdhërores nuk del nga veta e II-të shumë, duke hequr mbaresën *-ni*, sikurse pohojnë Gj. Pekmezi (Gram. d. alb. Spr. f. 171) e M. Domi (M. H. f. 56). Është e vërtetë se sot, po të heqim nga trajta e shumësit mbaresën *-ni*, ajo që mbetet është e barabartë me trajtën e njëjësit: *fal-ni* — *fal*, *njih-ni* — *njih*, *puno-ni* — *puno*, *shit-ni* — *shit* etj., por nga kjo nuk duhet të mendojmë se njëjësi është formuar nga shumësi me mënyrën që thamë, ashtu siç nuk mund të mendojmë që *bëj* është formuar nga *bëjmë* duke hequr mbaresën *-më*. Urdhërorja njëjës e foljeve konsonantike formohet nga tema e së tashmes së dëftores me anë të mbaresës *-ë*, cila do të ketë qenë e përgjithëshme, po me kohë ka ardhur duke rënë. Te Buzuku kjo mbaresë përdoret shumë më tepër se sa në gjuhën e sotme të shkrimit. Mendimin tonë e provojnë edhe të tilla trajta të Buzukut si (ti) *nxjerë*, *rjedhë*, *sjellë*, *zgedh*, të cilat përmbajnë diftongun *-je-* e jo zanoren *-i-*, siç do të pritej, po të vinin prej trajtave *ridhni*, *sillni* të shumësit.

Veta e II-të shumë duket se është formuar nga veta e II-të njëjës me anë të mbaresës *-ni*: (ti) *lypë*, *gëzo* — (ju) *lypëni*, *gëzoni*, njësoj

1) F. Bopp, Ueber das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen 471.

si lat. *orna* — *ornate*, *audi* — *audite* ose rus. *govori* — *govoritje*, *çitaf* — *çitajtje* etj. Prandaj kemi sot *bjereni*, *lereni*, *shpjereni*, *vëreni*, *zëreni*, ku shihet qartë se ruhen trajtat *bjer*, *ler*, *shpjer*, *vër*, *zër* të njejësit, ndërsa trajtat *bini*, *lini*, *shpini*, *vini*, *zini* janë trajta të dëftores që u shtrinë edhe në urdhëroren për analogji me ato raste, në të cilat urdhërorja e dëftorja janë përrputhur.

Ndrimi i tingujve *-e-*, *-je-* të rrënjës në *-i-* te veta e II-të shumë e urdhërores është spieguar si një ndikim i vetës së II-të shumë të dëftores, ku këtë ndrim besohet se e ka sjellë zanorja tematike *-i-* që mbeti si mbaresë pas rënies së mbaresës së vërtetë *-te* (**daln-i-te* > **dallite* > **dellit* > **dilli* > *dili*) (shih M. Domi. M. H. f. 47). Nga këto trajta të shumësit është ndikuar pastaj edhe njëjësi duke na dhënë që te Gjon Buzuku *uçil* nga **uçelë bdir* nga **bdjerë*, *vidh* nga **vjedhë* dhe në gjuhën e sotme *dil* nga **delë*, *vil* nga **vjelë* etj. ashtu si *nxirr*, *rridh*, *sill* nga *nxjerrë*, *rrjedhë*, *sjellë*, që na dësh-mohen te Buzuku.

Diateza pësore. Veta e II-të njëjës.

Trajta e diatezës pësore për njëjësin formohet me anë të përemrit refleksiv *u*, i cili mund të jetë herë proklitik herë enklitik, pa ndonjë rregull të qartë, p.sh. *daju n meje*, *Zot, përse u jam njeri i pëkatënuom* (135b31) — *e u daj n daj n këso sherbëtore* (32a6); *denjor u ty të të lëvdonj* (12b37) — *ti u denjo fruitinë e dheut me dhanë* (21a7), *neve u denjo me na gjegjunë* (21a10); *Regjina e Qiellsë, qëzo u* (10b37) — *hinë ndë hirt të zotit tit e u qëzo* (182a28); *ktheu prej meje, Zot* (15b43) — *liro gjithë të keq e u kthe nde e mirë* (145b10); *O Autore, kujto u n së shëlbuomit sinë* (3b17) — *Zot, mos u kujto* (15b31) etj., por kur ka në fjali një plotës thirr, duket se përemri refleksiv *u* përdoret më fort në enklizë. Raporti i përgjithshëm midis trajtave me *u* proklitike e *u* enklitike është 37 : 112. Në këtë numër 56 shëmbuj *u* përkasin trajtave *u lut* e *lutu*, nga të cilat e para është përdorur 1 herë, kurse e dyta 55 herë. Kur foljes i prin pjesëza mohore *mos*, e shumë herë edhe trajtat e shkurtëra *m(ë) e na*, pjesëza *u* vihet drejt përpara foljes: *mos u kujto* (15b31), *mos u ndaj n meje* (17a18), *mos u përkatëno* (11a10), *pa m u afëro* (68b15), e *ti neve na u dëfto* (8a37) etj.

Në pozicion enklitik pas një teme vokalike pjesëza *u* realizohet si gjysëm zanore, duke krijuar me zanoren prise një diftong zbritës *-ou*, *-eu*. Vetëm në një rast, te *denjoru* (21b27), këtë diftong e ka ndarë një, *-h-*. Foljet që në trajtën e vepron marrin pseudombaresën *-j-* si *daj*, *ruoj*, e kanë këtë tingull edhe në trajtën e pësore: *daju*, *ruoj*.

Veta e II-të shumë

Trajta pësore e vetës së II-të shumë të urdhërores ashtu si edhe e dëftores ka si mbaresë një *u* përgjithësisht dyfishe, të cilën Prof. E. Çabej e ka traskribuar si të gjatë. I. P.sh. *drekū*, *gjegjū* (3), *hiqi*, *kthielli*, *mbëlidhī*, *nvishī*, (4), *mos trembī* (3) *mos zemër-*

keqī (2), *çuditī* (2), *grëshitī*, *lutī* (15), *ritī*, *banī* (7). Për foljet e zgj. të III-të tema e së tashmes pësore është e zgjeruar me bashkëtingëlloren -n, e cila luan edhe rolin e një tingulli antihiatizues, duke qenë se të gjitha mbaresat vetore të së tashmes nisin me zanore (-em, -esh, -et etj., njësoj si në toskërishten jugore sot, ku thuhet *gëzonem*, *gëzonesh*, *gëzonet*, etj.). Nga kjo temë e tillë me anë të mbaresës -i formohet veta e II-të shumës e urdhërores: *fermonī*, *forconī*, *gëzonī* (10), *glorionī*, *kallëzonī*, *konfortonī* *konvertonī* (2), *kthenī* (3), *lutēnī*, *ndëronī*, *ngushullonī* (7), *pagëzonī*, *shumonī* (2), *trajttonī*, *trazonī*, *turbonī*. Foljet vokalike që nuk e kanë zgjeruar temën e së tanishmes me bashkëtingëlloren -n- e disa të tjera marrin midis temës e mbaresës një -h- antihiatizuese: *dahī* (2), *lahī*, *mbahī*, *dehī*, *ngrihi* (3), *përvihī*, *ruhī* (5).

Për vetën e III-të njëjës e shumës edhe Gjon Buzuku përdor gjerësisht pjesëzën le me trajtën përkatëse të lidhore, p.sh. *le ta danē* (80b20), *le të dīsh* (33a7), *le të grëshitetē* (25b12-13), *le të hinjē* (34a9), *le të jetē* (30a29), *le të lanē* (57a40-41, 112b24), *le të ndiglonjēnē* (66a42), *le të ndhezetē* (81b5), *le të ritetē* (47b33), *le të stripnjē* (100a25-26), *le ta shpëtonjē* (100a27), *le të vē* (87a9), *le të venē* (105b17).

Në lidhje me përdorimin e trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë me foljet e mënyrës urdhërore vemë re se pozicioni enklitik është mbizotërues te Gjon Buzuku.

Te ky autor gjejmë vetëm *hanie*, *linie*, *njihnie* etj. trajta të cilat mbizotërojnë edhe sot në gegërishten e labërishten;¹⁾ *epēnī* (2), *thëritēnī*, *zaminonī*, *zgidhnī* etj., *besonimē*, *birimē*, *ndiglonimē* *gjegjimē*.²⁾ Këta katër shëmbujt e fundit janë të pamundur në gjuhën e sotme. Në dialektet e tjera të toskërishtes trajtat e shkurtëra të përemrit vetor vendosen midis temës e mbaresës -ni të shumësit: *haj-e-ni*, *ler-e-ni*, *jep-i-ni*, *thërit-i-ni*, *beso-mē-ni*, *bjer-mē-ni* etj.

Po të duam të bëjmë një krahasim midis urdhërores siç paraqitet te Gjon Buzuku e siç paraqitet sot, dy janë zhvillimet kryesore që na bien në sy:

1) Mbaresa e vjetër -ë e trajtës veprare të njejësit në gegërishten ka rënë krejt duke hapur rrugën (khs. më lart f. 164) për rënien e zanores -ë kudo në pozicion fundor. Për Toskërishten, ndonse ortografia e gjuhës shqipe³⁾ rekomandon që të shkruhet *bjerë*, *folë*, *hyrë*, *ikë*, *shpjerë*, *shtjerë*, *zerë* -ë-ja fundore e këtyre trajtave nuk dëgjohej në shumë të folme, bile edhe në shqiptimin letrar. Duke u nisur nga kjo rrethanë, Sh. Demiraj e ka përjashtuar gati krejt zanoren -ë si mbaresë të urdhërores⁴⁾.

2) Mbaresa *ī* (= *ii*) e vetës së dytë shumës të diatezës pësore sot ka dalë nga përdorimi. Gegërishtja e formon tani këtë trajtë me anë të përemrit reflektiv *u* që i shtohet në enklizë trajtës veprare: *afroniū*, *çoniū*, *gzoniu*, *laniu*, *largoniū* etj. Trajtat *dahi*, *lahi*,

1) M. Totoni, *E folmja e Kurveleshit* (dorëshkrim)

2) Khs. dhe përzinima te Bardhi, *Parathënia*, f. 6.

3) «Ortografia e gjuhës shqipe», në Buletin për shkencat shoqërore, IV, 1956, f. 61.

4) Shaban Demiraj, «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe», Pjesa e II, Tiranë, 1961, f. 222v.

mbahi janë më të rralla dhe, me sa dimë ne, zanorja *-i* në të nuk është e gjatë. Toskërishtja trajtës pësore të njëjësit i shton *mbaresën -ni* të shumësit: *kapu — kapuni, ngjitu — ngjituni* etj.

Përsa u përket të tjerave pika që kanë të bëjnë me këtë mënyrë gjuha e Gjon Buzukut dhe gjuha e sotme nuk kanë ndonjë dallim të rëndësishëm ndërmjet tyre.

R é s u m é

LES FORMES DE L'IMPERATIF CHEZ GJON BUZUKU

L'auteur de cette communication reproduit les formes de l'impératif du Livre d'Heures ou Missel de Gjon Buzuku, le premier livre albanais paru en 1555 et écrit en un dialecte de l'Albanie du Nord-Est. Il fait remarquer que dans ces derniers 400 ans les formes de ce mode n'ont pas subi une évolution importante. La plupart de celles-ci, comme p. ex. le singulier et le pruriel de la diathèse active sont actuellement les formes prédominantes de la langue, d'autres subsistent dans les dialectes.

La langue de Gjon Buzuku, même pour ce qui est des formes de l'impératif, offre quelques oscillations qui ont leur importance. L'auteur, voulant relever celles-ci, donne dans tous les cas aussi le nombre de fois que toute forme a été employée.

Considérée dans son ensemble, la situation est la suivante: dans la diathèse active, les verbes à thème consonantique n'ont pas, dans la plupart des cas, une désinence: dëlir, puth; dans un petit nombre de cas ils se prennent la désinence -ë: këqyrë, lypë. Il en est de même aussi des verbes à thème vocalique, qui n'ont pas de désinence: beko, forco, ushqye, etc.

La forme du pluriel est formée, pour presque tous les verbes, à l'aide de -ni: delni, lëvdoni, vini, etc. Le singulier de la diathèse passive est formé à l'aide du pronom reflexiv u: gëzoḡ, ktheḡ, u kujto, qui peut être proclitique ou enclitique. Le pluriel prend, par contre, la désinence ii (=i) et plus rarement i: çuditī, lutī ritī, hiqi.

